



RAPORTI TOPOGRAFIK

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT:

“NDËRHJRJE PËR PËRMIRËSIMIN E AKSESIT TURISTIK, RRUGË BICIKLETASH, MOTORRASH,
SHTIGJE KËMBËSORËSH, VENDPUSHIMESH, PIKA TURISTIKE.”



"SISTEMIMI DHE MBROJTJA E ARGJINATURES LINDORE TE LAGUNES SE KARAVASTASE PREJ
EROZIONIT", FAZA II

PROJEKT ZBATIM

HARTUESI I PROJEKTIT:

B.O.E. "TAULANT" sh.p.k. & "ABKONS" sh.p.k.



TAULANT shpk
Design & Supervision

abkons
LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards

Duke u mbështetur ne termat e references për objektin: “Sistemimi I argjinatures ekzistuese përreth lagunes Karavasta, për mbrojtjen e lagunës dhe tokave bujqësore dhe kthimi i kurorës së saj në shëtitore këmbesore me hapësira rekreative” kemi hartuar relievin topografik ne te gjithë gjatesine e lagunes sipas gjurmes te paracaktuar ne projekt ide.

Para fillimit të punimeve kemi bere nje rikonicion te hollesishem ne terren dhe kemi grumbulluar materialet e nevojshme topografike ekzistuese per te gjithë zonen ku shtrihen objekti.

Materialet topografike dhe hartografike ekzistuese qe do te na ndihmojne per kryerjen e rilevimit qe perdorem jane:

- Hartat topografike te shkalles 1: 10 000 dhe 1: 25 000

- ortofotot 2015 (fotot aerofotogrametrike)

Për të siguruar qe te gjithë matjet topografike dhe hartimi i relievit te jete i mbeshtetur ne rrjetin shtetëror te koordintave, rilevimin topografik te te gjithë siperfaqes se kerkuar eshte realizuar duke u mbeshtetur ne Rrjetin Shtetëror Aktiv i Pozicionimit Global në territorin e Republikës së Shqipërisë **ALBCORS**.

Sistemi i koordinatave ekzistuese ne Republikën e Shqipërisë është i bazuar ne projektionin Gauss Kryger ne Elipsoidin Krasovsky.

Nivelacioni eshte mbeshtetur ne piken e Rrjetit Shtetëror te Nivelimit e materalizuar ne terren ne objektin e Hidrovorit Karavasta. Kjo pike nivelacioni eshte ndodhet ne murin perendimor te objektit e vendosur ne nje bllok betoni (shiko foton bashkengjitur). Kordinatat e kesaj pike jane:

NR	Emertimi	Klasa	X	Y	H
11125	Hidrovori Karavastase	III	528607.19	367291.31	T.11.832
					M.3.677



Foto te Pikes se rrjetit kordinativ

Matjet tona jane bere ne sistemin ndërkombëtar UTM 34N i projektuar ne elipsoidin WGS84. Me këtë sistem mund të përcaktohet lehtë koordinatat gjeodezike për çdo pikë në siperfaqen e tokës përmes përdorimit të GPS.

Relievi i detajuar (pikat detaje) eshte bere me Rover GPS (95% te siperfaqes rilevuese) dhe me Stacion Total (5% te siperfaqes rilevuese).

Pajisjet matese gjeodezike qe perdorem ne kete proces jane:

1. GPS tipi **SOKKIA GRX1**

2. Instrumentin Station Total Leica tipi **TM30**

Te dhenat e pikave detaje me GPS jane marre me metoden "stop & go ". Ne cdo pike detaje marresi i gps qendron 3-5 sek.

Ne rastet kur procesi i rilevimit eshte kryer me Instrumentin Station Total Leica tipi TM30, kemi shpeshuar pikat e poligonit dhe saktesia e marrjes se pikave detaje eshte perseri brenda saktesis se shkalles se rilevimit. Saktesia e afruar nga Instrumentin Station Total Leica tipi TM30 eshte:

- **Saktësia e matjes kendit = 1 "**

- **Saktësia e matjes se largësive = 0.6 mm + 1 ppm**

Procesi i rilevimit topografik te terrenit eshte bere sipas metodes klasike duke marre si pika detaje te gjithë pikat e rrugeve ekzistuese, te kanaleve eksistuese kulluese dhe vaditese, te kufirit te lagunes, bankinave, skarpateve, kanaleve anesore dhe muret mbajtese. Gjithashtu jane rilevuar rruget ekzistuese pa asfalt, te detajeve te ndryshme, te trotuareve, te linjave elektrike, te ndertesave te hidrovoreve ekzistuese, te kanaleve anesore te rruges, muret rrethuese te objekteve, shtyllat e ndricimit dhe elektrike, kryqezimet me rrugen kryesore dhe me rruget dytesore etj. Per cdo pike detaje jane marre kordinatat X, Y, Z. Pra cdo pike eshte e insertuar ne file te Autocad ne 3d. Perpunimi i te dhenave te marra ngaurvejimi ne terren jane perpunuar fillimisht me programin e kompesimit te rrjeti me **sokkia spectrum survey**, dhe perpunimi i metejsheem eshte bere me Autocad Civil.





Lidhja e rrjetit te poligonometrise me Rrjetin Shteteror te koordinatave.

Për të bërë të mundur transformimin e koordinatave dhe lidhjen e ketyre me sistemin e KRRGJSH (koordinatat e marra nga matjet e drejteperdrejta ne terren me GPS ne sistemin UTM), Rilevimin topografik I te gjithë siperfaqes se kerkuar eshte realizuar duke u mbeshtetur ne Rrjetin Shteteror Aktiv i Pozicionimit Global në territorin e Republikës së Shqipërisë ALBCORS. (bazuar në nenin 7, pika b, të ligjit nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 7.8.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH), si metadatë”, I ndryshuar , administron, menaxhon, ruan dhe përpunon të dhënat e sistemit ALBCORS duke garantuar aksesin për publikun dhe subjektet e interesuar).

Rrjeti Shteteror Aktiv i Pozicionimit Global në territorin e Republikës së Shqipërisë përfaqësohet nga rrjeti ALBCORS, i cili është realizuar në Sistemin Referencë Tokësor të Europës ETRS89 (European Terrestrial Reference System 1989) dhe në të njëjtën kohë shërben për mirëmbajtjen e kësaj reference në territorin e vendit tonë. Në përbërje të këtij rrjeti janë 21 stacione CORS të ndërtuara me blloqe betoni, 6 stacione CORS (roof type), të integruara nga sistemi i vjetër ALBPOS, dhe një qendër kontrolli e vendosur në ambientet e ASIG. Rrjeti Shteteror Aktiv i Pozicionimit Global, ALBCORS, në varësi dhe të metodës së matjeve dhe kushteve ideale të riveimeve GNSS në terren garanton për përdoruesit e tij saktësinë $\pm 2 - 3$ cm;

Te gjithë te dhenat e marra nga sistemi GPS ne kohe reale jane perpunuar duke u lidhur dhe bashkevepruar me kete system.

Koordinatat e pikave jane produkt I matjeve ne terren me sistemin GPS dhe te perpunuara me sistemin Albkors.

Koordinatat e pikave detaje jane pasqyruar ne nje table exel bashkengjitur ketij relacioni.

Per te mbeshtetur te gjitha punimet e zbatimit te ketij projekti kemi ndertuar nje poligonometri me 6 pika me kordinata qe jepen ne tabelen e meposhteme:

Nr	X	Y	H
1	367208.676	4526668.008	3.677
2	368744.106	4527341.841	1.603
3	368747.784	4527375.869	1.913
4	370634.263	4527358.629	0.998
5	375269.932	4535911.827	0.684
6	373516.184	4538208.896	1.858

Projektues:

B.O.E. “TAULANT” sh.p.k. & “ABKONS” sh.p.k.

Përfaqësues me prokurë:

Inxh. Ditika QATIPI

Përgatit:

Inxh. Sokol ALLARAJ

LIC TZ 0332/3

NIPT K71902003L